

## 215 PIKËQASJA E NJËSUAR – EMËR I NJËSISË POLITIKE-TERRITORIALE OSE EMËR GJEOGRAFIK

Fusha përmban pikëqasjen për emrin e njësisë politike-territoriale ose emrin gjeografik.

Emrat e njësive politike-territoriale që përdoren si pikëqasje lëndore, të vetme ose vetëm me përcaktuesit e shtuar lëndorë, trajtohen si emra territoresh (fusha 215). Emrat e njësive politike-territoriale që përdoren si pikëqasje për autorët, trajtohen si organizata (fusha 210). Si organizata trajtohen edhe emrat e njësive politike-territoriale, pas të cilëve ndodhet nënndarja për organizatën dhe të cilët përdoren si pikëqasje për autorët ose si pikëqasje lëndore.

### Nënfushat & përsëritshmëria

FUSHA/NËNFUSHA		PËRSËRITSHMËRIA
215	Pikëqasja e njësuar – emër i njësive politike-territoriale ose emër gjeografik	nr
	<b>a</b> <i>Elementi hyrës</i>	nr
	<b>x</b> <i>Përcaktuesi i përgjithshëm</i>	r
	<b>z</b> <i>Përcaktuesi kohor</i>	r
	<b>9</b> <i>Gjuha e pjesës kryesore të pikëqasjes</i>	nr

### Treguesit

Vlerat e treguesve nuk janë të përcaktuara.

## PËRSHKRIMI I NËNFUSHAVE

Nënfushat x dhe z janë përshkruar në kapitullin *Përcaktuesit*, ndërsa nënfusha 9 në kapitullin *Nënfushat e kontrollit*.

### 215a Elementi hyrës

Pjesa e emrit që në pikëqasje përdoret si element për klasifikim, që mundëson klasifikimin dhe kërkimin në katalog. Nënfusha është e detyrueshme.

## SHËNIME PËR PËRMBAJTJEN E FUSHËS

Fusha përmban formën e emrit të njësive politike-territoriale ose emrit gjeografik, që është formuar në përputhje me rregullat kombëtare të katalogimit ose me sistemin e emërtimeve lëndore.

Në SGC, përcaktuesit e përgjithshëm dhe kohor përdoren vetëm në regjistrimet referuese.

## FUSHAT NË LIDHSHMËRI

- 415** *VARIANTI I PIKËQASJES – EMËR I NJËSISË POLITIKE-TERRITORIALE OSE EMËR GJEOGRAFIK*
- 515** *PIKËQASJA NË LIDHSHMËRI – EMËR I NJËSISË POLITIKE-TERRITORIALE OSE EMËR GJEOGRAFIK*
- 715** *PIKËQASJA E NJËSUAR NË GJUHËN DHE/OSE SHKRIMIN TJETËR – EMËR I NJËSISË POLITIKE-TERRITORIALE OSE EMËR GJEOGRAFIK*

## SHEMBUJ

1.

215	uu	aUnited States xHistory
-----	----	-------------------------

2.

215	uu	aOntario xGuidebooks
-----	----	----------------------

3.

215	uu	aOntario xHistory z1801-1900
-----	----	------------------------------

4.

215	uu	aRocky Mountains
-----	----	------------------

5. \* COBISS.net

215	uu	aPorta e Ishtarit (Babiloni)
-----	----	------------------------------

6. \* COBISS.net

152	uu	bsgc
215	uu	aGlinje (Komuna Braslovçe, Slovenija) (Regjistrim për vendin Glinje në Rajonin Savinjska.)

152	uu	bsgc
215	uu	aGlinje (Komuna Cerklje në Gorenjska, Slovenija) (Regjistrim për vendin Glinje në Rajonin Gorenjska.)

7. \*

152	uu	bsgc
215	uu	aLuna

8. \* COBISS.net

152	uu	bsgc
215	uu	aKrka (Slovenija : përrua)